



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 86 Datë 26.12.2019

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	AGJENCIA RAJONALE E SHËRBIMIT VETERINAR MBROJTJES SË BIMËVE, SHKODËR
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP ☐ • Reklamim nga të tretë ☒
Numri i procedurave të verifikuara	1 (një)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë prokurimi me vlerë të vogël
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 28, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, me nenin 59, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe me Udhëzimin e APP Nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimi me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” të ndryshuar, lidhur me argumentimin dhe dokumentimin e përlogaritjes së fondit limit sipas këtyre dispozitave. 2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 40, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, lidhur me mospërcaktimin në ftesën për ofertë të të dhënave teknike dhe sasiore të mallit objekt prokurimi. 3. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me Udhëzimin e APP Nr. 2, datë 02.05.2019 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”, lidhur me kërkesën për paraqitjen e mostrave, ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
Masat e marra	Në bazë të neneve 13, pika 2/i, 66 dhe 72, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP vendosi t’i propozojë titullarit të Autoritetit Kontraktor, marrjen e masës disiplinore ndaj 3 (tre) anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.